



ILIRE ZAJMI AUTHOR

Literature Art Journalism

· HOME

April 25, 2017

LAURA GARAVAGLIA

**Autoportret**

Çdo mëngjes, midis flokëve dhe shkumës,
shkridhem pak më shumë në fund të vaskës.

Kujtimet fraktura të shpërfytyruara
hapa të ngadaltë në asfalt.

Indikativ i tanishëm

A je duke kërkuar edhe ti format e universit
mes gabimeve horizontale të ditës?
Çka nëse zeniti ishte në të vërtetë këtu
në parvazin e dritares mes vazos lulemine,
hija e pasdites te shkallët
në këtë mungesë memece të arsyes.
Ose sikur rrisku i dritës të ngatërrohej në lëndinë
ky çast i zverdhur
midis të kaluarës dhe të ardhmes?

Mekanika kuantike

Disa gjëra ndodhin
nuk mund ta dimë pse

Nuk do të jetë alkimia bërthamore
të na shpjegojë
gjashtë gradët e ndarjes

Questo sito utilizza cookie di Google per erogare i propri servizi e per analizzare il traffico. Il tuo indirizzo IP e il tuo agente utente sono condivisi con Google, unitamente alle metriche sulle prestazioni e sulla sicurezza, per garantire la qualità del servizio, generare statistiche di utilizzo e rilevare e contrastare eventuali abusi.

ULTERIORI INFORMAZIONI OK

të parashikosh fatin në llum kafeje
pa e ditur kush do të rri, e kush do të shkojë.
Nga pjesët e trupit më shumë se çdo gjë tjetër
e dua gojën që ushqehet nga bota
e gdhen fjalët.

Sindromi Asperger

Nuk e kuptoj
njollën e dhimbjes

ndjenjën e shprishur që vërshon
britmën e jetës.
Çrregullim i hidhur i pa formë
kërcënon enën e pafajshme
pastërtinë e numrit
e të simbolit
sekuencë e rregullt
sistem i përkryer.

Vera

Era e katranit në fund të molit,
dhëmbët e qenit kafshojnë kreshtën.
Flluska e ylbhtë e verës
fluturon tatëpjetë në ajrin e nxehtë
pa e ditur në cilin drejtim zemra udhëton.
Nga e gjithë ajo dritë që zmadhoi ditën
mbeti vetëm pëlhura e shlyer e jastëkut,
alga e thatë lakuar mbi shkëmb,
sytë e Santa Lucia-së mbi kanape
përqafimi i përgjakshëm i meduzës në qafën time.

Vera 2

Ndoshta ishte vera e kaluar, apo e një viti më parë.
Spektakli, është përherë i njëjti: të dënuarit
zhytur deri në gjoks, njeriu i kokosit,
yndyra e kremit të rrezitjes në gazetë
Vetëm sfondi ndryshon.

Laura Garavaglia

E lindur në Milano në vitin 1956, Laura Garavaglia jeton dhe punon në qytetin e Komo-s. Shkrimtare e publiciste, ajo bashkëpunon me disa revista letrare dhe shtëpi botuese në Itali.

Ka botuar përmbledhjet me poezi: “Fragmente të jetës”, “Shumë kultura”; “Flutura e gurë”, “Simetria e thelbit”. Poezitë e saj janë përkthyer në disa gjuhë të huaja e janë përfshirë në shumë antologji. Themeluese e asociacionit kulturor “Shtëpia e poezisë në Komo”. Ideatore dhe kuratore e Festivalit Ndërkombëtar të poezisë “Evropa në vargje” që mbahet në Komo të Italisë.

nga gjuha italiane: Ilire Zajmi

Questo sito utilizza cookie di Google per erogare i propri servizi e per analizzare il traffico. Il tuo indirizzo IP e il tuo agente utente sono condivisi con Google, unitamente alle metriche sulle prestazioni e sulla sicurezza, per garantire la qualità del servizio, generare statistiche di utilizzo e rilevare e contrastare eventuali abusi.

ULTERIORI INFORMAZIONI

[Share](#) [Email Post](#)

Labels: [Festival Europa in versi](#), [Italian Poetry](#), [Woman poets](#)

Ancora nessun commento



Aggiungi un commento come Laura Garavaglia

Post a Comment

POPULAR POSTS

Questo sito utilizza cookie di Google per erogare i propri servizi e per analizzare il traffico. Il tuo indirizzo IP e il tuo agente utente sono condivisi con Google, unitamente alle metriche sulle prestazioni e sulla sicurezza, per garantire la qualità del servizio, generare statistiche di utilizzo e rilevare e contrastare eventuali abusi.

ULTERIORI INFORMAZIONI **OK**



September 24, 2018

SHTËPIA E FËMIJËRISË

Share

March 28, 2014

ME POEZI KUNDËR DHUNËS NDAJ GRUAS

Share

 Powered by Blogger

Theme images by Deejpilot

@ ilirezajmi



Questo sito utilizza cookie di Google per erogare i propri servizi e per analizzare il traffico. Il tuo indirizzo IP e il tuo agente utente sono condivisi con Google, unitamente alle metriche sulle prestazioni e sulla sicurezza, per garantire la qualità del servizio, generare statistiche di utilizzo e rilevare e contrastare eventuali abusi.


ULTERIORI INFORMAZIONI **OK**

Prishtina, Kosova,
Albania

—
Ilire Zajmi is writer from Prishtina, Kosovo. Ilire writes poems, and prose. Author of ten books. Five poem collections. Three published in Albanian language, "Këmbanat e mëngjesit" "Baladë e bardhë" and "Valsi i mesnatës"; "Amnesia" published in Portugal by Corpus Editora, and "C'est la fin" published by l'Harmattan in France. Author of two novels "Fashitja e ëndrrave rebele", "Era", and a publicistic book "Un treno per Blace" published in Italian language, 1999 in Italy. This book is translated in Albanian and Croatian language. "Television pictures and reality" study book, published by Saga publishing house, Kosovo. Ilire Zajmi poems are translated in many languages. She is presented with poems in many literary anthologies. Ilire Zajmi is winner of special prize for poetry "Venttenale" in the international poetry contest held in Milan -Italy in the 20 -th edition 2011. Winner of the national poetry prize "Mitingu i Poezise" 2013.

[VISIT PROFILE](#)

[Blog Archive](#) 

[Labels](#) 

[Report Abuse](#)

Questo sito utilizza cookie di Google per erogare i propri servizi e per analizzare il traffico. Il tuo indirizzo IP e il tuo agente utente sono condivisi con Google, unitamente alle metriche sulle prestazioni e sulla sicurezza, per garantire la qualità del servizio, generare statistiche di utilizzo e rilevare e contrastare eventuali abusi.

[ULTERIORI INFORMAZIONI](#) [OK](#)